



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
AVOKATI I POPULLIT  
Seksioni i Fëmijëve



Adresa: Bulevardi: "Zhan D'Ark" Nr.2  
Tiranë, Shqipëri

Tel/Fax: +355 4 2380 300/315  
E-mail: [ap@avokatipopullit.gov.al](mailto:ap@avokatipopullit.gov.al)  
[www.avokatipopullit.gov.al](http://www.avokatipopullit.gov.al)

Nr. Prot.  
Nr. Dok. 201701676/2

Tiranë \_\_\_/\_\_\_/2018

**Lënda :** Rekomandim për marrjen e masave për regjistrimin e fëmijës së shtetasit R. A., në gjendjen civile Shkodër.

**Drejtuar:** Znj. Rudina Kalaja  
Njësia për Mbrojtjen e Fëmijëve  
Bashkia Shkodër

**Për dijëni:** Znj. Rajmonda Bozo  
Drejtore ekzekutive  
Shoqata TLAS  
Adresa: Blv: Bajram Curri, Pall. Agimi, Shk.18, Ap. 322

**Tiranë**

Ju informojmë se pranë institucioni të Avokatit të Popullit ka paraqitur ankesën shtetasi Remzi Alibali, i cili kërkon ndihmë juridike për të regjistruar vajzën e tij, aktualisht 14 vjeç, të lindur në Gjermani, në gjendjen civile, Shkodër.

Në zbatim të legjislacionit në fuqi për regjistrimin e fëmijëve duhet të plotësohen dy kushte (i) të kryhen analizat e AND-së së fëmijëve dhe (ii) disponimi i Vendimit të Gjykatës për njohjen e atësisë së tyre. Të dyja këto kushte kanë nevojë për shërbime të cilat kanë kosto të lartë financiare dhe nuk mund të përballohen nga shtetasi Remzi Alibali

**Në zbatim të nenit 8, të Konventës Për mbrojtjen e të Drejtave të Fëmijëve të ratifikuar nga Shteti Shqiptar, thuhet se** *"1. Shtetet Palë marrin përsipër të respektojnë të drejtën e fëmijës për të ruajtur identitetin e tij, përfshirë këtu shtetësinë, mbiemrin dhe lidhjet familjare, sipas ligjit, pa ndërhyrje të paligjshme. 2. Në qoftë se një fëmije i mohohen në mënyrë të paligjshme disa ose të gjithë elementet e identitetit të tij, Shtetet Palë i japin atij ndihmën dhe mbrojtjen e duhur, me qëllim që identiteti i tij të rivendoset shpejt."* çdo fëmijë gëzon të drejtën për të patur identitetin e tij.

Në këto kushte, Institucioni i Avokatit të Popullit si institucion i pavarur në mbrojtje të të drejtave dhe lirive të njeriut, ku përfshihen edhe të drejtat dhe liritë e fëmijëve, si dhe në zbatim të nenit 30, të ligjit Nr.8454, datë 4.2.1999, "Për Avokatin e Popullit në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar, ku thuhet se *"Në kryerjen e funksioneve të veta,*

*Avokati i Popullit bashkëpunon ngushtë me organizatat joqeveritare, duke marrë periodikisht mendimet e tyre për gjendjen e të drejtave dhe të lirive të njeriut” në përmbushje të detyrimeve që rrjedhin nga Konventa për Mbrojtjen e të Drejtave të Fëmijëve vlerëson bashkëpunimin me shoqatën “TLAS”, Tiranë të cilën kanë dhënë një kontributë frutëdhënëse në mbështetjen e kategorive në nevojë, veçanarisht fëmijëve për ofrimin e shërbimeve ligjore falas për të gëzuar të drejtën e tyre, e saksionuar edhe në Ligjin Nr. 18/2017 datë 23.2.2017 “Për të drejtat dhe mbrojtjen e fëmijës”, e drejta për të patur një identitet.*

Në vazhdimësi sqarojmë se nga komunikimi i realizuar me email ndërmjet Shoqatës “TLAS” dhe Institucionit të Avokatit të Popullit vlersojmë gadishmërinë e treguar nga kjo shoqatë për të mundësuar shërbimin ligjor falas për raste të fëmijëve që kanë nevojë për ndihmë ligjore falas, për të përmbushur të drejtën e mohuar deri tashmë.

Në zbatim të VKM nr. 266 datë 12.04.2012 “Për bashkërendimin e veprimtarisë së mekanizmave në nivel qendror dhe vendor për çështjet që lidhen me mbrojtjen e të drejtave të fëmijës” dhe Udhëzimit nr. 10, datë 25.2.2015 “Për mënyrat, format e bashkëpunimit dhe procedurat e ndërhyrjes në ndihmë të fëmijëve në rrezik për institucionet dhe strukturat kryesore përgjegjëse për mbrojtjen e fëmijës” si dhe në zbatim të nenit 21 të ligjit Nr.8454, datë 4.2.1999, ”Për Avokatin e Popullit në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar “*paraqet rekomandime për vënien në vend të së drejtës së shkelur tek organi administrativ, që, sipas tij ka shkaktuar shkelje të të drejtave dhe lirive*”;

#### **REKOMANDOJMË:**

Marrjen e masave për mbështetjen e familjes së shtetasit R. A., për regjistrimin e vajzës së tij 14 vjeç në zyrën e gjendjen civile Shkodër me kontributin e shërbimit ligjor falas të Shoqatës “TLAS”, Tiranë.

Në zbatim të nenit 22 të ligjit Nr.8454, datë 4.2.1999, ”Për Avokatin e Popullit në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar detyrimi i organeve të administratës për t’ju përgjigjur institucionit të Avokatit të Popullit është brenda 30 ditësh nga data e dërgimit të shkresës zyrtare.

Duke ju falenderuar për bashkëpunimin,

**K O M I S I O N E R I**

**Ermir KAPEDANI**